




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.7, datë 11.02.2026



PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT "ITALDRURI ELBASAN" SH.P.K, ME
VENDNDODHJE: BASHKIA ELBASAN.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime të ndryshme (sanitare), të subjektit "ITALDRURI ELBASAN" sh.p.k, me vendndodhje: Bashkia Elbasan.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi):

- $X = 505858.65$
- $Y = 4551450.54$
- $Z = 106.69 \text{ m}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.9 \text{ l/sek}$

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për përdorim të brendshëm sanitar.

- Thellësia e pus-shpimit: 250 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : -90 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

X= 505923.29;

Y= 4551455.13;

Z= 105.64 m

- Prurja që shkarkohet: Q= 0.72 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

